



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Mbështetje për Parlamentin
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

POLITIKA MBËSHTETËSE PËR KUALIFIKIMIN DHE PUNËSIMIN E MËSUESEVE TË GJUHËS ROME

PËRGATITUR NGA
BUJAR TAHO¹,
KONSULENT LIGJOR DHE POLITIKASH PUBLIKE

MAJ 2022



1 Ky dokument është pasuruar më tej nga komentet dhe sugjerimet e vlefshme të dhëna nga disa prej përfaqësuesve të shoqërisë civile rome të cilët janë: z. Raxhi Rakipi (Aktivist dhe mësues i licensuar i gjuhës shqipe dhe rome, z. Sead Kazanxhiu (Nënkryetar i Komitetit të Pakicave Kombëtare), z. Erion Xhaibra (Anëtar i Komitetit të Pakicave Kombëtare), z. Olsi Sherifi (Aktivist dhe gazetar pranë RTSH-së), z. Emiliano Aliu (Drejtor Ekzekutiv i Organizatës 'Roma Versitas Albania'), znj. Manjola Veizi (Drejtore Ekzekutive e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome), znj. Brisilda Taço (Aktiviste), z. Adriatik Hasantari (Drejtor Ekzekutiv i Organizatës 'Roma Active Albania') dhe z. Bledar Taho (Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri).

PËRMBLEDHJE

Ligji Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare², në zbatim të kërkesave kushtetuese³ dhe detyrimeve ndërkombëtare⁴ në Nenin 13 (paragrafi 1 dhe 2), u garanton personave që i përkasin një pakice kombëtare, ku përfshihet edhe pakica rome, të drejtën *për të mësuar gjuhën e pakicës* (në çdo njësi vendore ku ata banojnë) dhe të drejtën *për të marrë mësim në gjuhën e pakicës* (në njësitë vendore ku ata banojnë tradicionalisht ose në numër thelbësor). Gjithashtu, Neni 13 (paragrafi 5) i ligjit në fjalë ngarkon Këshillin e Ministrave që me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin të miratojë masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisje me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve si dhe për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare. Në zbatim të këtij ligji, janë miratuar edhe disa akte nënligjore,⁵ ndërsa janë në proces projektvendimi mbi përdorimin e gjuhës së pakicave gjatë ndërveprimit me organet e vetëqeverisjes vendore dhe projektvendimi mbi vetë-identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare.⁶

Pavarësisht kuadrit ligjor përgjithësisht të miratuar,⁷ mungesa e politikave mbështetëse për studentët që kanë ndjekur programin “Bachelor” në gjuhët shqipe dhe rome, të ngritur prej 2015 pranë Departamentit të Gjuhësisë në Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan, ka çuar në ndërprerjen e këtij programi gjatë dy viteve të fundit, duke penguar kualifikimin e mësuesve të gjuhës rome dhe bërë të pamundur mësimdhënien e gjuhës rome në shkolla, sipas kërkesave të kuadrit ligjor. Për më tepër, mungon një program kualifikimi ‘Master në gjuhët shqipe dhe rome’ ku të mund të studiojnë të diplomuar të shkencave të tjera sociale, humane, dhe arteve, të cilët kanë njohuri të gjuhës rome dhe dëshirojnë të specializohen si mësues të kualifikuar të kësaj lënde. Ndërkohë, edhe pse ka pasur disa iniciativa për mësimin e gjuhës rome në shkolla si pjesë e programit Shkolla Qendër Komunitare nuk është siguruar financimi i nevojshëm dhe i qëndrueshëm i tyre. Për t’iu përgjigjur kësaj situate dhe në zbatim të detyrimeve ligjore kërkohet marrja e masave të menjëhershme për: (a) përfshirjen e studentëve që i përkasin pakicës rome ndër kategoritë e studentëve në nevojë për efekt të përjashtimit nga tarifa vjetore në të gjitha ciklet e studimeve universitare dhe



2 Ligji për Pakicat Kombëtare, nr. 96/2017, në: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf> (vizituar së fundmi në 25 prill 2022)

3 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998, e ndryshuar), Neni 3 parashikon, ndër të tjera, bashkëjetesa dhe mirëkuptimi me pakicat kombëtare janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë. Po ashtu, Neni 20 i Kushtetutës (interpretuar me VGJK 52/2011), garanton se personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore.

4 Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; shih Komentari Tematik nr. 3, datë 24 maj 2012, i Komitetit Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare “Të Drejtat Gjuhësore të Personave që u Përkasin Pakicave Kombëtare sipas Konventës Kuadër,” në: <https://rm.coe.int/16800c1207> (vizituar së fundmi në 25 prill 2022)

5 VKM nr. 561, datë 29.9.2018 Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”. VKM nr. 562, datë 29.9.2018” Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”; VKM nr.115 datë 24.12.2020 “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.

6 Raport i Komitetit të Pakicave Kombëtare, aksesuar në 25 prill 2022.

7 Organizatat e shoqërisë civile rome ngritën shqetësimin se Shqipëria ende nuk ka miratuar Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (1992) të Këshillit të Evropës, e cila synon në mënyrë specifike promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve të pakicave historike dhe rajonale në Evropë, pjesë e së cilës duhet të konsiderohet edhe gjuha rome.



aplikimi i bursës së plotë për këtë kategori për çdo degë përfshirë edhe degët e mësuesisë⁸; (b) kategorizimin e programeve Bachelor dhe Master (pas çeljes së këtij të fundit) në gjuhët shqipe dhe rome' ndër programet e studimit të fushave prioritare në vend me të gjitha efektet që rrjedhin, përfshirë në mënyrë të veçantë përjashtimin e studentëve rom nga kriteri i mesatares, bazuar edhe mbi praktikën që zbatohet për kandidatët me origjinë shqiptare nga vendet e rajonit⁹; si dhe (c) garantimin e punësimit, sipas rastit, të instruktorëve (të diplomuarit "Bachelor") dhe mësuesve (të diplomuarit Master), të gjuhës rome dhe çeljen e klasave për mësimin e gjuhës rome.

PROBLEMATIKA

Fëmijët që i përkasin pakicës kombëtare rome përballen me vështirësi të shumëfishta që pengojnë frekuencimin e rregullt dhe mësim-nxënien në arsimin e detyruar duke vështirësuar kalimin në nivelet e tjera arsimore. Krahas sfidave ekonomike, sociale, e ndërkulturore, një pengesë vendimtare është edhe komunikimi i dobët i fëmijëve rom në gjuhën shqipe, i cili vështirësohet edhe për faktin se gjuhën rome këta fëmijë e mësojnë jo përmes rregullave gramatikore, jashtë kujdesit të institucioneve arsimore dhe nga prindër me nivel të ulët arsimor. Kështu, mësimi i gjuhës rome jashtë kujdesit të institucioneve arsimore, jo vetëm cenon nivelin e të kuptuarit dhe të shprehurit në gjuhën rome të këtyre fëmijëve, por bashkë me të vështirëson kuptueshmërinë, ndjekjen dhe përvetësimin e mësimin edhe në gjuhën shqipe. Si rezultat, për shkak të **vështirësive gjuhësore në gjuhën shqipe, shpesh rënduar nga mësimi i parregullt i gjuhës rome, shumë fëmijë rom mbeten mbrapa e jo rrallë braktisin edhe shkollën.**

Në përgjigje të kësaj nevojë, në kuadrin e programit Shkolla Qendër Komunitare¹⁰ janë zhvilluar edhe klasa të gjuhës rome në disa shkolla të vendit ku studiojnë nxënës të pakicës rome në Elbasan, Tiranë, etj. Megjithatë, **financimi i këtyre programeve është mbështetur në angazhimin vullnetar të instruktorëve të gjuhës rome apo kryesisht në burime të organizatave jo-fitimprurëse dhe si pasojë mësimi i gjuhës rome nuk ka mundur të vijoj në mënyrë të qëndrueshme.**¹¹ Këto klasa janë zhvilluar nga instruktorë të cilët ose kanë përfunduar studimet Bachelor në degën e gjuhëve shqipe dhe rome ose janë diplomuar në shkenca sociale e humane të ndryshme nga mësuesia, dhe zotërojnë mirë gjuhën rome.

Sipas të dhënave të Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri të konsultuara edhe me përfaqësues, aktivistë dhe drejtues të organizatave të shoqërisë civile rome, në vend janë mbi 10 të diplomuar rom në disiplina si, drejtësi, gazetari, ekonomik, marrëdhënie me publikun,

8 Në këtë kuadër, ndër të tjera, nevojitet amendimi i VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 (ndryshuar së fundmi me VKM Nr.755, datë 30.11.2019)"Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë".

9 Neni 3 i VKM nr. 436/03.06.2020 përjashton nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.

10 Shih, Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare, miraturar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, miraturar në 13.03.2014, në: https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/01/Standardet_SHQK_2014.pdf (vizituar së fundmi në 25 prill 2022).

11 Të dhëna nga intervista me Z. Raxhi Rakipi, një prej të diplomuarve në programin Bachelor në gjuhët shqipe dhe rome në Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan.

politika publike, histori, akademi akti, etj., të cilët zotërojnë mirë gjuhën rome dhe nëse do të mbështeteshin për t'u kualifikuar në një program studimi Master Profesional në gjuhët 'shqipe dhe rome' do të ishin të gatshëm ta ndiqnin me qëllim që të mund të punësoheshin më pas si mësues të kualifikuar të gjuhës rome. Prandaj, **hapja e një programi të tillë masteri në 'gjuhët shqipe dhe rome' pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan,**¹² përkrah programit Bachelor, përbën një masë të nevojshme.

Gjatë 2015-2019 studimet Bachelor në degën gjuhë shqipe dhe rome janë diplomuar rreth 15 studentë rom dhe jo-rom, nga të cilët 6 kanë përfunduar edhe studime Master dy-vjeçar për mësuesi.¹³ Siç raportohet, shumica e të diplomuarve në këtë degë në pamundësi për t'u punësuar në pozicione që lidhen me fushën e studimeve kryejnë punë që nuk kërkojnë kualifikim universitar ose janë larguar nga vendi. Procesi i gjatë dhe i kushtueshëm për të përfunduar studimet Bachelor 3-vjeçare, e Master 2-vjeçar, e më pas praktikën 1 vjeçare së bashku me mungesën e perspektivës për t'u punësuar si instruktor ose mësues i gjuhës rome ka dekurajuar studentët e rinj që të zgjedhin këtë program studimi. Për më tepër, kriteri i notës mesatare që kërkohet për të ndjekur degët e mësuesisë (përfshirë edhe atë në gjuhët shqipe dhe rome) është një pengesë serioze për kandidatët e interesuar, e veçanërisht atyre që i përkasin pakicës rome, të cilët për një shumëllojshmëri shkaqesh përfundojnë me vështirësi shkollën e mesme, shpesh nën mesataren e kërkuar për studime të larta 6.5. Si pasojë e mos plotësimit të numrit minimal të studentëve që prej 2019 është ndërprerë edhe ofrimi i programit të studimit Bachelor në degën gjuhë shqipe dhe rome.

Edhe pas ndryshimeve të bëra në muajin maj 2022, studentët që ndjekin degët e mësuesisë edhe me mesatare 6.5 nuk mund të punësohen si mësues. Sipas deklaratave të znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit dhe Sportit "Për ata që synojnë të bëhen mësues, mesatarja e pranimit në këto degë do të vijojë të jetë 7.5, por për studentët e tjerë që synojnë të vijojnë studime për një tjetër profesion si përkthyes, psikolog, punonjës social, ciceron, historian, gjeograf, etj., kjo mesatare pranimi mund të jetë minimalisht 6.5."¹⁴ Thënë ndryshe, edhe ulja në 6.5 e mesatares në degët e mësuesisë nuk mundëson studentët rom që e plotësojnë këtë kriter për t'u punësuar si mësues të gjuhës rome.

Në përgjigje të kësaj situatë, nevojitet ndërhyrja e menjëhershme dhe strategjike në disa drejtime. Fillimisht dhe për të garantuar rezultatet konkrete që mundësojnë pjesëmarrjen e romëve në arsimin e lartë, nevojitet që kandidatët që i përkasin pakicës rome të përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të mesatares edhe nën 6.5 në degët ku



- 12 Shih, Universiteti Aleksandër Xhuvani Elbasan, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhësisë, Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Rome, në: <https://uniel.ems.al/school/program/b7fd11ee-16be-4904-b42b-a81800bec526.aspx> (vizituar së fundmi në 25 prill 2022).
- 13 Të dhëna të konsultuara me z. Raxhi Rakipi, njëri prej 15 studentëve të diplomuar në programin e studimit Bachelor 3-vjeçar në degën 'Gjuhë Shqipe dhe Rome, i cili pasi përfundoi edhe studimet Master Shkencor në gjuhë shqipe, përfundoi procedurën e licensimit si mësues.
- 14 Cituar nga: <https://gazetasi.al/ulet-mesatarja-ne-disa-programe-bachelor-kushi-nuk-ndryshojne-kriteret-per-mesuesine/>; Shih VKM nr. 436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", në: <https://ualbania.al/theme/files/VKM%20p%C3%ABr%20p%C3%ABrcaktimin%20e%20kriterit%20t%C3%AB%20not%C3%ABs%20mesatare%20p%C3%ABr%20vitet%20akademike%202020-2021%20DHE%202021-2022.pdf> (vizituar së fundmi në 31 maj 2022). Sipas Nenit 1 (b) të kësaj VKM-je, mesatarja e kërkuar për ciklin Bachelor në degët të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë Master në fushën e mësuesisë është të paktën 7.5. Këtë e afirmon edhe pika 3/1 e VKM-së 436/03.06.2020 shtuar në 26 maj 2022, sipas të cilët mesatarja e kërkuar për studimet Bachelor edhe pse ulet në 6.5 për degët e fushës së mësuesisë nuk i njeh të drejtën studentëve me mesatare nën 7.5 të drejtën për të ndjekur studime në ciklin Master në fushën e mësuesisë.

ata janë të nënpërfaqësuar apo ku përfshirja e tyre ndihmon në integrimin e pakicave dhe marrëdhëniet e mira ndërkulturore me popullsinë e shumicës. Në fakt, një përjashtim i tillë aplikohet me të drejtë për kandidatët me origjinë shqiptare nga disa vende të rajonit (Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci).¹⁵ Kjo nënkupton që studentët me origjinë shqiptare që vinë nga këto treva mund të ndjekin studime Bachelor e Master për çdo degë, përfshirë edhe mësuesi, me një mesatare nën 6.5. Bazuar mbi këtë përvojë, përjashtimi i kandidatëve shtetas shqiptar që i përkasin pakicës romë përbën një masë pozitive që duhet vlerësuar periodikisht në përputhje me politikat për integrimin dhe përfshirjen e pakicës romë. Në këtë drejtim, nevojitet që Neni 3 i VKM-së nr. 436/03.06.2020 të plotësohet duke shtuar edhe kandidatët që i përkasin pakicës romë ndër kategoritë e kandidatëve që përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të mesatares. Gjithashtu, nevojitet kategorizimi i degës 'gjuhë shqipe dhe romë' (në nivel Bachelor dhe Master) ndër fushat prioritare të studimeve universitare, duke e bashkëshoqëruar këtë masë jo vetëm me përjashtimin e studentëve romë nga tarifat vjetore për të gjitha nivelet e arsimit universitar, por edhe me dhënien e bursës së plotë studentëve romë si kategori në nevojë. Më tej, po aq përparësi i duhet dhënë edhe garantimit të punësimit të të diplomuarve romë, si 'instruktor i gjuhës romë' (të diplomuarit Bachelor në gjuhë shqipe dhe romë) dhe 'mësues i gjuhës shqipe dhe romë' (të diplomuarit që përfundojnë edhe programin Master). Paralelisht me plotësimin e kushteve të mësipërme është e nevojshme të nisin përgatitjet për çeljen e klasave të gjuhës romë dhe hartimin e kurrikulës edhe në gjuhën romë për lëndë që paraqesin interes të veçantë, si historia, gjeografia, letërsia, etj.

KONKLUZIONE

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ndërkombëtare, Shqipëria ka miratuar ligjin nr. 96/2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare, i cili ndër të tjera u garanton fëmijëve të pakicave kombëtare të drejtën për të mësuar gjuhën e pakicës dhe të drejtën për të marrë mësim në gjuhën e pakicës që i përkasin. Zbatimi në praktikë i këtij ligji, kërkon fillimisht përgatitjen dhe punësimin e mësuesve të kualifikuar të gjuhës romë. Ndonëse përgatitja dhe punësimi i mësuesve të kualifikuar në degën e gjuhës shqipe dhe romë është kusht për ushtrimin e të drejtës së fëmijëve romë për të mësuar gjuhën romë, mësimi i saj në shkollë dhe me udhëzime në shqip përbën gjithashtu një mjet efektiv për të ndihmuar fëmijët romë të përballojnë më lehtësisht vështirësitë e komunikimit në gjuhën shqipe. Mosmarrja e masave të duhura në këtë drejtim thëllon mungesën e aksesit të fëmijëve romë në arsimin ndërsa u mohon atyre të drejtën për të mësuar gjuhën e pakicës.

15 Shih, Nenin 3, VKM nr. 436/03.06.2020.

REKOMANDIME

- **Përfshirja e studentëve që i përkasin pakicës rome ndër kategoritë e studentëve në nevojë, përjashtimi nga tarifa vjetore në të gjitha ciklet e studimeve universitare dhe dhënia e bursës së plotë nga fondet e shtetit për studime Bachelor dhe Master.** Ndonëse bursa e plotë është një minimum i domosdoshëm, vlera e saj është e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shkollimit përgjatë gjithë ciklit të kualifikimit fillestar si mësues. Në këto kushte, kërkohet që, krahas bursës së plotë nga fondet e shtetit, në bashkëpunim me fondacione ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare që studentëve që studiojnë në 'degën e gjuhëve shqipe dhe rome' t'u ofrohet mbështetje e plotë financiare që mbulon të gjitha shpenzimet e jetesës dhe atyre studimore për një total prej 6 vitesh, përgjatë gjithë cikleve të studimit Bachelor (3-vjeçar) dhe Master (2 vjeçar) si dhe praktikës kualifikuese (1-vjeçare). Kjo politikë duhet zbatuar deri në arritjen e një numri thelbësor mësuesish të kualifikuar të gjuhës rome për shkollat 9 vjeçare dhe një numër të arsyeshëm lektorësh të kualifikuar të gjuhës rome në universitete.
- **Kategorizimi i 'programeve Bachelor dhe Master në gjuhët shqipe dhe rome' ndër programet e studimit në fusha prioritare me të gjitha efektet që rrjedhin nga kjo, përfshirë në veçanti, përjashtimin e kandidatëve rom nga kriteri i mesatares duke vlerësuar rast pas rasti edhe kandidatët me mesatare nën 6.5.** Pranimi i studentëve rom në universitet me mesatare nën 6.5 mund të ndjekë përvojën me studentët që vinë nga trevat shqiptare dhe të realizohet duke vlerësuar vështirësitë individuale që studentët rom kanë hasur gjatë shkollës së mesme dhe përpjekjet e tyre për të kontribuar në komunitet, në çdo rast duke marrë rekomandime përkatëse nga institucioni arsimor ku kandidati ka kryer studimet dhe organizata rome me të cilin kandidati është angazhuar. Për më tepër, nevojitet ngritja e një programi studimi 'Master Shkencor në gjuhët shqipe dhe rome' pranë Departamentit të Gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit (krahas programit "Bachelor"), ku të mund të studiojnë të diplomuarit të nivelit Bachelor të të gjitha disiplinave e kryesisht ata të shkencave sociale, humane, dhe arteve, të cilët dëshirojnë të kualifikohen si mësues të gjuhës rome.
- **Garantimi i punësimit, sipas rastit, të të diplomuarve në Bachelor në gjuhën shqipe dhe rome si *instruktur i gjuhës rome* dhe të të diplomuarve në Master në degët e mësuesisë si *mësues i gjuhës shqipe dhe rome*, si dhe mbështetje financiare kësaj kategorie për të kryer studime doktorale në fushën e mësimdhënies së gjuhës e kulturës rome.** *Të diplomuarve në programin 3 vjeçar të degës 'gjuhë shqipe dhe rome' në Universitetin e Elbasanit, t'u garantohet punësim ose si instruktor i gjuhës rome ose si specialist pranë programeve publike, përfshirë por pa u kufizuar në programet e qendrave komunitare të bashkive, programet e drejtorive arsimore 'Shkolla Qendër Komunitare', etj., që zbatohen në zona të banuara nga anëtarë të pakicës rome. Të diplomuarve Bachelor në 'degën e gjuhë shqipe dhe rome' të cilët përfundojnë studimet Master në degë të mësuesisë t'u garantohet punësim si mësues i gjuhës shqipe dhe rome. Po ashtu, të diplomuarve në degë të tjera të cilët kanë përfunduar studime Master Shkencor dhe zotërojnë njohuri të mira të gjuhës rome, t'u krijohen mundësi punësimi si asistent-lektor apo asistent-hulumtues pranë*

Departamentit të Gjuhësisë në Universitete dhe të mbështeten financiarisht për të ndjekur studime doktorale në fushën e mësimdhënies së gjuhës e kulturës rome.

- **Çelja e klasave të mësimi të gjuhës rome dhe përgatitja graduale e kushteve për mësimin e disa prej lëndëve të kurrikulës shkollore (p.sh. historia, gjeografia, letërsia, etj.) edhe në gjuhën rome.** Në këtë drejtim, nevojitet që ofrimi i *mësimi të gjuhës rome të realizohet përmes një qasjeje që mundëson mësimin e gjuhës rome dhe njëkohësisht lehtëson rritjen e kuptueshmërisë dhe përvetësimin e mirë të gjuhës shqipe*. Për këtë arsye, të gjithë mësuesit e kualifikuar dhe licensuar të gjuhës rome duhet t'u vihen në dispozicion tekste për mësim-dhënie të gjuhës rome për nxënës shqipfolës, duke u bazuar në materialet burimore të Degës 'Gjuhë Shqipe dhe Rome' në Departamentin e Gjuhësisë pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan dhe kurrikulat kuadër të gjuhës rome të hartuara nga Këshilli i Evropës.¹⁶
- Fillimisht, ***mbështetja financiare mund të orientohet drejt çeljes së klasave për mësimin e gjuhës rome nga 'instructorë të gjuhës rome'*** (të cilët njohin gjuhën rome dhe zotërojnë një diplomë universitare të paktën në nivelin Bachelor në shkencë sociale, humane, arte, etj.). Sugjerohet që mësimi i gjuhës rome të financohet e vihet në zbatim fillimisht në kuadrin e programit Shkolla Qendër Komunitare (SHQK) në zona të caktuara urbane e gradualisht edhe në ato rurale. Në zonat ku është i mundur punësimi i mësuesve të kualifikuar në 'gjuhë shqipe dhe rome', mësimi i gjuhës rome të shndërrohet gradualisht nga një veprimtari e programit SHQK në një lëndë me zgjedhje në kurrikulën e arsimit të detyruar. Paralelisht, kërkohet të punohet që lëndë të caktuara nga kurrikula shkollore (p.sh. historia, gjeografia, letërsia, etj.) të mund të mësohen edhe në gjuhën rome krahas asaj shqipe. Për këtë qëllim, lind nevoja e konsultimit me organizatat e shoqërisë civile rome, Komitetin e Pakicave Kombëtare, dhe ekspertë të kurrikulave dygjuhëshe, apo bilinguale.

16 Shih, Kurrikulumin Kuadër për Gjuhën Rome (Curriculum Framework for Romani) zhvilluar nga Këshilli i Evropës, në: <https://www.coe.int/en/web/language-policy/romani> (vizituar së fundmi në 25 prill 2022).



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo- qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Projekt i:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Shënim: Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe të NDI – Institutit Demokratik Amerikan. Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së.